BIBLIOTEKA
SHTETIT
8JH-32
Xh 17

SHEFQET XHAFA

PAJTIMI

TREGIME

894-32

SHEFQET XHAFA

PAJTIMI

Tregime

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktore: *Irena Dono*
Piktor: *Spiro Kristo*

Tirazhi 4.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974

PAJTIMI

Në zyrën e shefit të repartit Terezina hyri me ndrojtje. Padashur fytyra e saj e bardhë mori një ngjyrë të kuqe. Shefi diçka po shkruante mbi një regjistër të madh. Fytyra e tij e gjerë dhe e mbushur, syzet dhe flokët e zbardhur i ngjallën vajzës së re respekt.

— Ju jeni shoku Azem? — e pyeti ajo.

— Po — iu përgjigj ai pa ndërprerë punën.

— Zyra e kuadrit më dërgoi te ju.

Ai ngriti kokën, hoqi syzet dhe, si fshiu sytë, tha:

— Ju kanë dërguar si nxënëse?..

— Jo... Jam teknike e mesme — tha ajo pak si me mburrje dhe i zgjati letrën që i kishte dhënë kuadri. Shefi e vështroi për një çast sikur donte ta maste me sy.

Në shtëpinë e Terezinës të gjithë ishin mekanikë, babai, vëllezërit dhe xhaxhallarët e saj. Edhe Terezina. megjithëse ishte vajzë, nuk shpëtoi dot nga ky zanat.

Ti, Terezina, mund të punosh si frezatore — i thoshin shpesh ata. Sipas tyre ky zanat ishte më i përshtatshëm për vajza.

— Keni punuar ndonjëherë në frezë? — e pyeti shefi me një ton të rëndë e tërë autoritet.

— Kam punuar pak kohë në ofiçinën e shkollës — iu përgjigj vajza, e cila nga toni i rëndë i shefit e ndjente veten si në gjemba.

— Atëherë, vajzë e mirë, nesër do të fillosh nga puna — foli shefi.

Një emocion ia përshkoi trupin vajzës së re në këto çaste. Janë emocionet e zakonshme që të pushtojnë kur fillon punën për herë të parë. Ti ëndërron, të duket vetja e madhe, e pjekur.

Një vajzë e gjatë dhe e bukur hyri me të shpejtë në zyrë. Vajza mbante disa çelësa në dorë. Ajo i hodhi Terezinës një vështrim plot kureshtje dhe i buzëqeshi lehtë.

— E ndreqe? — pyeti shefi me atë tonin e tij të zakonshëm.

— E ndreqa, shoku Azem — tha ajo. — Megjithatë, në qoftë se makina nuk punon mirë, më thërrisni përsëri.

— Të lumtë, vajzë! — tha ai i kënaqur nga fjalët e saj.

Terezina e mori me mend se vajza ishte rimontiere. Kjo gjë i bëri shumë përshtypje. Gjer tani ajo nuk kishte dëgjuar që vajzat merren edhe me rregullimin e makinave.

— Mund të shkoj, shoku Azem? — pyeti ajo pas pak.

— Jo, prit pak. Diçka dua të të them — shtoi ai, ndërsa vazhdonte të shkruante mbi atë regjistrin e madh që kishte përpara.

Terezina e kuptoi se tani duhej të dilte jashtë. Nuk kishte ndonjë arsye që të qëndronte më gjatë.

Shefi i kishte thënë që nesër të fillonte punën dhe kjo ishte e mjaftueshme për të.

Terezina doli nga zyra e shefit, po i hodhi edhe një herë sytë andej para se të largohej. Remontierja fliste e bënte gjeste me duar.

— Si e quajnë atë vajzë? — pyeti ajo një punëtor që ishte aty pranë.

— Cilën, sportisten? — tha ai. — Flutura e quajnë, Flutura.

— Pse, merret me sport ajo?

— Po, luan basketboll — tha punëtori duke filluar përsëri punën.

Terezina u largua nga punëtori dhe filloi të vinte rrotull nëpër repart. Vëmendjen ia tërhoqën proceset e ndryshme të punës dhe makinat e shumta gjigante që i komandonin disa vajza të cilat ishin moshatare me të.

«Sa gjë e çuditshme», tha ajo me vete. Pastaj vajti te vendi ku do të punonte. Makina ishte fare e re, pa filluar ende nga puna. Pak më tutje punonte një frezë tjetër e cila ishte më e madhe se freza e saj. Ajo pa se aty punonte një djalë i gjatë flokëverdhë, i cili i hodhi vajzës një vështrim tërë kureshtje.

Ai diçka deshi të pyeste, po Terezinës s'i pëlqeu vështrimi i tij dhe i hodhi një shikim të egër.

«Shpejt do të njihem me të gjithë e do të zë shoqëri. E sidomos me atë sportisten, e cila m'u duk një vajzë e dashur», mendoi me vete tek po dilte nga uzina.

* * *

Të nesërmen shefi i repartit e priti buzagaz
— Ja, kjo është makina ku do të punosh — i tha ai. — Siç e shikon freza është fare e re. Duhet ta ruash e ta mbash pastër. Pranë ke edhe këtë shokun, të cilin mund ta pyesësh në qoftë se gjatë punës has ndonjë pengesë.

Ai u largua duke e lënë vajzën ballë për ballë me makinën e saj. Nga ana praktike Terezina e ndjente veten ca të dobët. Koha e paktë që kishte punuar në ofiçinën e shkollës ishte e pamjaftueshme. Pastaj edhe detalet që ata prodhonin ishin mësimore. Në uzinë çdo detal i nënshtrohej kontrollit dhe futej në magazinë. Kjo gjë e shqetësonte shumë vajzën e re. A do të ishte ajo vallë në gjendje t'i përgjigjej cilësisë së prodhimit?

Ditët e para e pati ca të vështirë, po dalngadalë u ambientua me punën dhe me njerëzit.

Njerëzit filluan ta donin dhe ta respektonin. Një shoqëri të ngushtë Terezina zuri me Fluturën. Ajo iu duk një shoqe shumë e mirë, e dashur dhe e sjellshme. Ajo u mërzit shumë kur mori vesh historinë e hidhur të Fluturës, martesën dhe ndarjen e saj.

Burri i saj ishte pikërisht ai frezatori të cilin Terezina e kishte pranë. Flutura kishte edhe një vajzë që e quanin Kozeta.

* * *

Tani me shokun e saj të punës Terezina sillej ftohtë. Ata flisnin vetëm atëherë kur kishin për t'i marrë ndonjë vegël njëri-tjetrit. Vajza, kur mori vesh se Shkëlqimi kishte qenë burri i Fluturës, ndjente për të neveri. Shkëlqimi dukej njeri nervoz dhe i mbyllur në vetvete. Terezinës i dukej sikur ai mbante qëndrim armiqësor, ndoshta nga shoqëria e ngushtë që ajo kishte me Fluturën. Kështu kalonte koha dhe Terezina vazhdonte të punonte në frezën e saj. Deri atëherë ajo nuk kishte hasur në ndonjë vështirësi.

Një ditë në mëngjes shefi i repartit i thërriti që të dy frezatorët në zyrë. Ai u foli mbi rëndësinë e disa detaleve që do të bënin dhe nevojën e madhe që kishte ekonomia për to, prandaj kërkohej që ata të punonin bashkë, sepse vetëm ashtu ato detale mund të prodhoheshin më shpejt.

Në fillim vajza kundërshtoi me këmbëngulje. Nuk donte të punonte me atë njeri. Edhe Shkëlqimit nuk i pëlqente të punonte me Terezinën. Kjo gjë dukej në vështrimet që i hidhte shefit. Aty kishte dhe habi dhe kundërshtim. Shefi urdhëroi që ata të fillonin menjëherë nga puna. Dashur padashur Terezina u detyrua të punonte në mënyrë kolektive me Shkëlqimin. Detalin e fillonte Terezina duke i bërë procesin e parë të punës, kurse Shkëlqimi kryente operacionin përfundimtar. Duke shfrytëzuar më mirë kohën e punës, vajza arriti të bënte më shumë detale se ortaku i saj. Kjo gjë ra në sy të punëtorëve që punonin pranë tyre. Ata filluan ta ngacmonin:

— Ta kaloi vajza, or Shkëlqim!.. Lere më mirë fare zanatin!

Shkëlqimi i vështronte pak si me inat dhe s'u kthente përgjigje. Ditët e tjera ai e la prapa vajzën, megjithëse ajo bëri përpjekje për ta arritur. Sedra profesionale kishte bërë punën e saj. Pas disa ditësh pune të përbashkët, ata sikur e ndjenin veten më të afërt me njëri-tjetrin. Detalet e kërkuara i prodhuan në një kohë të shkurtër.

Gjatë kësaj kohe ai kishte mbajtur peshën më të madhe të punës. Ajo e dinte shumë mirë këtë. Terezina shpesh mendonte për shoqen që ishte ndarë prej tij. Ajo gjithmonë kishte menduar se fajtor për ndarjen ishte Shkëlqimi. Dhe ndoshta kështu mund të ishte. Ku ta dije. Burrat ngandonjëherë i fshehin të metat e tyre. Ajo kishte dëgjuar diçka nga Flutura, se vjehrra kishte qenë e egër, se Shkëlqimi ishte shumë xheloz dhe nuk kishte dashur që ajo të merrej me sport.

«Nuk dua që gruaja ime të më dalë lakuriq në mes të njerëzve» — kishte thënë ai.

Terezina kishte marrë vesh se nga shokët e uzinës ishin bërë përpjekje për t'i bashkuar. Me sa kishte dëgjuar edhe Shkëlqimi vetë kishte vajtur disa herë për ta marrë. Po Flutura nuk kishte pranuar.

Ajo e dashuronte ende Shkëlqimin, sado që me të ishin ndarë me gjyq. Terezina këtë e ndjente, ndonëse Flutura nuk i fliste për të.

Terezina mendoi t'u tregonte në shtëpi dhe të merrte mendimin e njerëzve të saj. Asaj i vinte sinqerisht keq që dy të rinjtë ishin ndarë për grindje të vogla, kur e donin njëri-tjetrin. Ata nuk e njihnin Shkëlqimin. Rasti e bëri që të njiheshin

me të. Terezinës i ndodhi një aksident në makinë dhe Shkëlqimi, që u ndodh pranë saj, e shpëtoi. Që atë ditë Shkëlqimi u bë mik shtëpie. Ai vinte shpesh tek ata. Babai i Terezinës ashtu larg e larg ia zinte me gojë çështjen e ndarjes me Fluturën. Ai nuk fliste ose mundohej t'i dredhonte muhabetit. Kur prindërit e Terezinës ia thanë hapur dëshirën që kishin për t'i bashkuar, ai i kundërshtoi, u tha se kjo gjë ishte e pamundur. Ndoshta atij i vinte rëndë të bashkohej pas gjithë atyre që ndodhën: gjyqi, njerëzit që flisnin... Pastaj nuk dihej nëse ai e dashuronte ende Fluturën...

Të gjitha këto e bënë shtëpinë e mekanikëve të heshtte dhe të hiqte dorë nga përpjekjet për t'i pajtuar.

— Me zor nuk bëhet asgjë — thoshin ata. Po Terezina qëndronte në të sajën. Ajo mundohej të bindte Shkëlqimin se Flutura e donte. Këtë gjë e bënte dhe me Fluturën.

*

* . *

Kishin kalur dy muaj dhe nuk kishte ndodhur asgjë. Dy të rinjtë vazhdonin të qëndronin të ndarë. Shkëlqimi donte që ajo ta linte sportin. Flutura nuk mund ta pranonte këtë.

— Unë nuk mund të rroj pa sport — i thoshte ajo Terezinës.

Flutura kishte të drejtë. Ajo ishte rritur me basketbollin. Ishte një nga pjesëtaret më të vjetra të ekipit.

Më 5 tetor Terezina kishte datëlindjen. Ajo